REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:117547

Datë: 23.09.2020

Numri i dokumentit: 01134708

P.nr.172/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Adnan Kamberi, në çështjen penale kundër të pandehurit G.H. për shkak të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par. 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë – Departamentit të Përgjithshëm PP. II. nr. 7466/18, të datës 22.01.2019, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës së shqyrtimit fillestar, verbal dhe publik me datë 16.09.2020 në prani të Prokurorit të Shtetit, të akuzuarit, më datë 16.09.2020 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 22.09.2020, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:
G.H., nga babai H., dhe nëna V., e gjinisë B., I lindur më (data e lindjes...), me adresë banimi në rr. "A.K.", nr..., në P., ka të kryer shkollën fillore, mekanik, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr.personal ..., shqiptar, shtetas I Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 26.10.2018, rreth orës 00.50, në rrugën "Ç.", përball Fakultetit Teknik në Prishtinë, i pandehuri me dashje, me qëllim të dëmtimit të pasurisë së hauj të luajtshme, fillimisht me automjetin e tipit Golf 5, ngjyrë e kaltër, me targa të regjistrimit ..., e ka tejkaluar dhe i'a ka zënë rrugën të dëmtuarit P.I., i cili po e drejtonte automjetin e tipit "Ford Fiesta". ngjyrë e kuqe , me targa të regjistrimit ..., pastaj posa ka dalur nga automjeti i tij është ofruar automjetit të dëmtuarit të lartcekur dhe me dorën e djathtë i'a ka dëmtuar pasqyrën, me ç'rast të njëjtit i ka shkaktuar dëm material-,

- **Me këtë ka kryer veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par. 1, të KPRK.**

Andaj, gjykata konform neneve 85, 86, 187 par. 3 të KPRK-së, si dhe neneve 498, 499, 500 të KPP-së, të pandehuri, **I SHQIPTON:**

2019:117548

VËREJTJE GJYQËSORE

I pandehuri detyrohet që ne emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 20 euro ne emër të paushallit gjyqësor, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën, numër PP. II. nr. 7466/18, të datës 22.01.2019, kundër të pandehurit G.H. nga Prishtina, për shkake të veprës Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par. 1, të KPRK-së.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 242 par. 3 lidhur me par. 4 të KPP-së, pasi vlerësojë kompetencën lëndore dhe territoriale për të proceduar ne këtë çështje penalo juridike, me datë 16.09.2020 ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar ne prani të Prokurorit të Shtetit dhe të pandehurit.

Ne seancën e shqyrtimit fillestar pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, i pandehuri G.H. ka pranuar ne tërësi fajësinë për veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par. 1, të KPRK-së.

Lidhur me pranimin e fajësisë Prokurori i Shtetit ne shqyrtim fillestar deklarojë se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pasi që konsiderojmë se pranimi i fajësisë është bërë konform nenit 248 të KPP-së. I pandehuri i ka kuptuar pasojat dhe benifitet e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, si dhe pranimi i fajësisë mbështetet ne provat të cilat gjenden ne shkresat e lendes. Andaj i propozojë gjykatës që të pandehurit t'i shqiptojë vërejtjeje gjyqësore, pasi që e njëjta është adekuate për veprën penale të kryer dhe pasojën e vogël e cila është shkaktuar me veprën penale të kryer.

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë për të pandehurin G.H. ne mbështetje të nenit 248 të KPP-së, dhe ne këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit R.B. mbështetet ne provat me të cilat disponon kjo gjykatë. Gjykata konstaton se ne bazë të provave të cilat gjenden ne shkresat e lendes vërtetohet perteje çdo dyshimi të bazuar mirë se i pandehuri: me datë 26.10.2018, rreth orës 00.50, në rrugën "Ç.", përball Fakultetit Teknik në Prishtinë, i pandehuri me dashje, me qëllim të dëmtimit të pasurisë së huaj të luajtshme, fillimisht me automjetin e tipit Golf 5, ngjyrë e kaltër, me targa të regjistrimit ..., e ka tejkaluar dhe i'a ka zënë rrugën të dëmtuarit P.I., i cili po e drejtonte automjetin e tipit "Ford Fiesta". ngjyrë e kuqe , me targa të regjistrimit ..., pastaj posa ka dal nga automjeti i tij është ofruar automjetit të dëmtuarit të lartcekur dhe me dorën e djathtë i'a ka dëmtuar pasqyrën, me ç'rast të njëjtit i ka shkaktuar dëm material.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga shkresat e lëndes, nga deklarimi i palëve ne procedurë dhe nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, dhe vëtetojë se ne veprimet e të pandehurit G.H. ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par. 1, të KPRK-së me përshkrimin faktik si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata dhe e shpalli fajtorë të njëjtin duke i shqiptuar vërejtjeje gjyqësore duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit veçanërisht duke marr parasysh qëllimin e vërejtjes gjyqësore, sjelljen e kryesit në të kaluarën, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale.

Gjykata, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë e dënimit nga neni 73 të KPRK, për të pandehurin G.H., për veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par. 1, të KPRK-së, ka aplikuar dispozitat nga neni 85 dhe 86 të KPRK-së, duke i shqiptuar vërejtjen gjyqësore. Me rastin e caktimit te vërejtjes gjyqësore si lloje i sanksionit penale, gjykata morri parasysh rrethanat lehtësuese dhe rrethanat rënduese, gjykata vlerësojë si rrethanë lehtësuese: se i pandehuri ka pranuar fajësinë në tërësi për veprën penale për të cilën akuzohet ne seancën e shqyrtimit fillestar, se i pandehuri është i moshës së vjetër dhe i njëjti ka shprehur keqardhje për veprën penale të cilën e ka kryer, se ai ka treguar sjellje korrekte ne gjykatë, se i pandehuri ka bashkëpunuar me organet e ndjekjes ne fazën e hetimit. Gjykata, nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese.

Gjykata, duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe rrethanat rënduese të pandehurit i shqiptojë vërejtjen gjyqësore duke i bërë me dije se ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën vepër penale dhe nëse kryen prapë vepër të tillë, gjykata do të shqiptojë sanksion më të rëndë penal.

Konform nenit 453 par. 1 të KPP-së, gjykata e ngarkon te pandehurin ne pagimin e shpenzimeve te procedurës penale si ne diapozitiv te këtij aktgjykimi.

Nga ajo çfarë u tha me lart, në bazë të neneve 498, 499 të KPP-së, dhe nenit 85 dhe 86 të KPRK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr. 172/19, të datës 22.09.2020

G j y q t a r i
Adnan Kamberi

KËSHILLA JURIDIKE:
Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar e drejta e ankesës në afatin prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa i drejtohet gjykatës së Apelit ne Prishtinë, nëpermjet kësaj gjykate ne kopje te mjaftueshme për gjykatën.

2019:117548